




KOMUNA RAHOVEC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštun Upravu

Nr. i prot. 4884 Më 19.10.2022
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



[RAPORT TREMUJOR I PUNËS]

Korrik-Shtator 2022

Zyra e Kryetarit Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n, 21000, Rahovec –Kosovës Tel: 0382004534

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

PËRMBAJTJA

Drejtoria e Shërbimeve Publike

PËRFUNDIM.....

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2022, përkundër sfidave dhe vështirësive në ekzekutimin e projekteve kapitale ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktivitetesh përgjatë kësaj periudhe tremujore. Në vazhdim DSHP ka raportuar për aktivitetet kryesore që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Aktivitetet në periudhën: korrik, gusht, shtator 2022

- Është bërë përrurimi i ndriçimit publik në rrugën kryesore te linjës Brestoc-Hoqë e Vogël me gjatësi mbi 2,5 km,
- Janë përfunduar procedurat për zgjedhjen e anëtarit (1 anëtarë) të bordit për KRM Ekoregjonin dhe 4 anëtarë të tjera për bordin e stacionit te autobusëve,
- Ka pasur aktivitete në rehabilitimin e gropave në qytet nga kompania KRU Gjakova,
- Ka pasur aktivitete në ndërtimin e trotuareve në fshatin Malësi e Vogël në drejtim të Gexhës përgjatë rrugës rajonale, poashtu ne rrugën Tafil Zyberaj dhe në fshatin Nagac,
- Janë bërë disa ndërhyrje në rregullimin e rrugëve dhe mbulimin e gropave si dhe pozicione të tjera si kanalizime dhe ndërhyrje emergjente ne rrugë,
- Kane filluar punimet ne rrugën 4 korsi, në lot 3 Mendi-P ka filluar punën, pritet të fillon edhe ne lot 2 kompania Euroasphalt ne pozicione jashtë trupit te rrugës ekzistuese,
- Është nënshkruar marrëveshja në mes komunës së Rahovecit dhe KRU Gjakovës për rregullimin e zgjidhjes se problemit me ujë te pijshëm në fshatrat Vrajak dhe Bertatin,
- Është nënshkrua marrëveshja me Ministrinë e Infrastrukturës për rregullimin e rrugëve ne qytet,
- Janë dërguar kërkesa ne Ministri për financimin e projekteve kapitale nga komuna,
- Kemi fillu me mirëmbajtjen e hapësirave publike, janë bere pastrimet përgjatë lumbit Duhlo, është bërë ujitja e drunjëve e rregullt, si dhe ka pasur intervenime tjera ne shume pozicione,
- Është mbajtur takime me grupin punues për reforma ne menaxhim te mbeturinave me donatoret JICA,
- Ne bashkëpunim me GIZ dhe partneret te tjera kemi identifikuar numrin e deponive ilegale, disa janë eliminuar disa po presim te eliminohen sipas mundësive ne teren, ne total janë gjithsej 11 deponi,

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

- Kane vazhduar mbledhja e të dhënave nga tereni për plotësimin e planit për mobilitet si dhe planet tjera te nevojshme sipas kërkesave të dalura nga indikatorët e performances.
- Me ndërtimin e rrugëve lokale janë duke punuar ne disa pozicione, njeri lot ne Krushë të Madhe nga kompania KAG ndërsa tjetri nga kompania Etniku, poashtu janë rikthyer punimet ne Sapniq dhe ne Potoqan te Poshtëm nga kompania Gashi Ing,
- Janë eliminuar deponite ilegale ne rrugën rajonale Rahovec-Suharekë si dhe ne rrugën transite,
- Nga data 15 korrik janë vendosur shenjat ne rrugën Xhevati Kasapi ne orar te kufizuar, nga ora 19.00 deri 23.00, për muajin e mërgimtareve,
- Është bërë shënjezimi i rrugës një kahore ne rrugën "Ibrahim Rugova" dhe "Xhafer Nurkasa", pas zyrtarizimit te kontratës për shenjezim, në rrugën Ibrahim Rugova është krijuar trotuar i ri si dhe shtegu për bicikleta,
- Është përfunduar diskutimi publik lidhur me planin e menaxhimit te mbeturinave,
- Ka përfunduar një segment i rrugës në fshatin Nagac si dhe ndërtimi i një pjese te trotuarit,
- Gjatë muajit gusht ka filluar mirëmbajtja e hapësirave publike,
- Janë përfundu disa tabela lidhur me PZHK dhe planin për Hartografi,
- Është miratuar vendimi ne kuvendin komunal lidhur me planin e menaxhimit te mbeturinave,
- Pas vërvimeve qe kane ndodhur ne kete periudhe kemi bere ftese ne AME dhe FSK qe te bëjmë disa ndërhyrje ne pastrim te rrugëve dhe kanaleve sipas nevojës, tashme siq e dini njësia e FSK-ka përfunduar hapjen e kanalit ne Fortese,
- Ka filluar ndërtimi i rrugëve lokale te komuniteteve ne lagjen e epërme dhe këndi i lojërave, ky investim eshte bashkëfinancim me MAPL, pjesa e grantit mbulohet me 40,000.00 euro,

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2020 janë:

- Sfidat e drejtorisë do të janë mundësítë buxhetore që kemi si drejtori, kemi shumë kërkesa të ndërtimit të rrugëve lokale për të përfunduar rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara,
- Mirëmbajtja e përrenjve dhe kanaleve që gjenden në vendbanime dhe në lagjet urbane,
- Kërkesa të vazhdueshme për ndriçim publik; për ndërtim të trotuareve; mbeturinat e amvisërisë që fatkeqësish hidhen kudo, vend e pa vend ku krijohen deponitë ilegale;

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

Përfundim

Ky raport përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Ju faleminderit!

Rahovec, 19.10.2022

